

L I G J

Nr.8529, datë 23.9.1999

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7662,
DATË 19.1.1993 “ PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES SË BIMËVE”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7662, datë 19.1.1993 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 paragrafi 5 ndryshohet si vijon:

"Me "Produkt për Mbrojtjen e Bimëve (PMB)" emërohet çdo produktet që përmban një ose më shumë lëndë aktive të cilat përdoren:

a) për mbrojtjen e bimëve dhe të produkteve bimore nga parazitët ose për parandalimin e veprimit të tyre;

b) për të ndikuar në proceset jetësore të bimëve, por me veprim të ndryshëm nga plehërat kimike (për shembull: rregullatorët e rritjes);

c) për të shkatërruar bimët e padëshirueshme ose pjesët bimore, si dhe për të mbajtur nën kontroll ose për të parandaluar rritjen e pjesëve bimore të padëshirueshme."

Pas paragrafit 7 shtohen këta paragrafë:

"Me "Mbetje të PMB-së" nënkuptohet një ose më shumë lëndë aktive të pranishme në bimë ose në produkte me origjinë bimore, në produkte të ngrënëshme me origjinë shtazore ose në mjedis si pasojë e përdorimit të PMB-së, duke përfshirë këtu metabolitet dhe produktet që dalin nga shpërbërjet e tyre."

Me "Mbrojtje të integruar" nënkuptohet përdorimi i kombinuar dhe i arsyeshëm i masave biologjike, bioteknologjike, kimike dhe teknikave të kultivimit, të cilat kufizojnë përdorimin e PMB-së në minimumin e nevojshëm për të mbajtur popullatat e parazitëve në atë nivel, në të cilin dëmi ekonomik është i pranueshëm.

Me "Çertifikatë fitosanitare" nënkuptohet një dokument zyrtar, që vërteton gjendjen fitosanitare të një ngarkese, e cila është subjekt i inspektimit fitosanitar."

Neni 2

Pas nenit 2 shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje:

"Mbrojtja e bimëve dhe e produkteve bimore kryhet në bazë të Praktikave të Mira të Mbrojtjes së Bimëve dhe kriterëve të mbrojtjes së integruar."

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si vijon:

"Ministri, me urdhër, shpall listën e parazitëve karantinorë dhe bën ndryshime sa herë që kjo vlerësohet e domosdoshme."

Neni 4

Në nenin 5 hiqen fjalët "ose agronomi i mbrojtjes së bimëve në komunë".

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si vijon:

“Në rastet e përhapjes masive të parazitëve, Ministri ka të drejtë të mobilizojë kundrejt pagesës, mjetet e nevojshme për mbrojtjen e bimëve nga çdo person që i zotëron ato.”

Neni 6

Në nenin 8 fjalët “pesticidet dhe shpenzimet e nevojshme për trajtim” zëvendësohen me fjalët “shpenzimet e nevojshme”.

Neni 7

Në nenin 9 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Të gjitha materialet bimore për shumëzim, të çertifikuara ose standarde lejohet të përdoren vetëm pasi t’i jenë nënshtruar inspektimit fitosanitar dhe të jenë pajisur me çertifikatë fitosanitare.”

Neni 8

Në nenin 10, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“Kalimi i tyre bëhet vetëm në ato pika doganore të caktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në të cilat funksionon inspektimi karantinor fitosanitar.”

Neni 9

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Për zbatimin e këtij ligji, inspektori në pikat doganore bashkëpunon me policinë kufitare, me punonjësit e doganës, me agjencitë rrugore, detare e hekurudhore, me kapitenerinë e porteve detare, me inspektoratin sanitar shtetëror dhe inspektoratin veterinar për problemet që lidhen me to. Ai është pjesëtar i grupit të praktikës që bën kontaktin e parë.”

Neni 10

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë fjalët “pa u kontrolluar e pajisur me çertifikatë fitosanitare” zëvendësohen me fjalët “pa u inspektuar e të papajisura me çertifikatë fitosanitare”.
- Në paragrafin e dytë fjalët “që kontrollohen” zëvendësohen me fjalët “që inspektohen”.

Neni 11

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

Fjalët “kur rezultojnë” zëvendësohen me fjalët “nëse pas inspektimit rezultojnë” dhe fjalët “në pikën kufitare të kontrollit” zëvendësohen me fjalët “në pikën doganore të inspektimit fitosanitar”.

Neni 12

Në nenin 23, në paragrafin e parë hiqen fjalët “dhe organet e tjera të mbrojtjes së bimëve”.

Neni 13

Në nenin 24, pas fjalëve “Mbajtja dhe shumëzimi i parazitëve” shtohet fjala “karantinor”.

Neni 14

Pas nenit 24 shtohet neni 24/1 me këtë përmbajtje:

“Janë objekt i inspektimit fitosanitar toka, kompostot dhe mjediset e ndryshme organike ose inorganike që përdoren për kultivimin e bimëve.”

Neni 15

Në nenet 25 e 26 emërtimi “Komisioni Shtetëror i Pesticideve” zëvendësohet me emërtimin “Komisioni Shtetëror i Regjistrimit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve”(KSHRPMB). ”.

Neni 16

Në nenin 27, fjala “Komitetit të Pesticideve” zëvendësohet me fjalët “Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve”.

Neni 17

Në nenin 30 hiqen fjalët “për afate të caktuara”.

Neni 18

Në nenin 31 hiqen fjalët dhe fjalët “si dhe të shtyjë afatin e përdorimit të licencës mbi bazën e kërkesave të bëra dy muaj para skadimit të saj”.

Neni 19

Në nenin 33, para fjalëve “Drejtoria e bujqësisë në rreth” shtohen fjalët “Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe”.

Neni 20

Neni 34 ndryshohet si vijon:

“Leje për tregtimin e PMB-ve u jepet personave fizikë apo juridikë apo personave të punësuar pranë tyre, vendas apo të huaj, të diplomuar në Fakultetin e Agronomisë dhe të pajisur me dëshimi kualifikimi për PMB-të nga Instituti i Mbrojtjes së Bimëve.”

Neni 21

Neni 35 ndryshohet si vijon:

“Produktet për mbrojtjen e bimëve paketohe, etiketohen, transportohen, ruhen, tregtohen, përdoren dhe asgjësohen në përputhje me specifikimet e dokumenteve të regjistrimit dhe të gjitha akteve të tjera ligjore e nënligjore për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve, mjedisit dhe mbrojtjen nga zjarri.”

Neni 22

Në nenin 43 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Drejtoria e Shërbimit të Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit harton politikën e mbrojtjes së bimëve dhe ndjek zbatimin praktik dhe shkencor të saj.”

- Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Struktura dhe kompetencat e Inspektoratit përcaktohen nga ministri.”

Neni 23

Neni 44 ndryshohet si vijon:

“Instituti i Mbrojtjes së Bimëve është institucioni kërkimor, shkencor kombëtar, i cili në mbështetje të këtij ligji është i ngarkuar të bëjë:

- kontrollin cilësor të PMB-së dhe të mbetjeve të tyre në bimë, në produkte bimore, në ujë dhe në tokë;

- diagnostikimin dhe prognozë - sinjalizimin e parazitëve të bimëve, duke këshilluar edhe masat e luftimit të tyre;

- inventarizimin dhe monitorimin e parazitëve karantinorë, duke përcaktuar metodat e kontrollit dhe ato të parandalimit të përhapjes së tyre;

- provat biologjiko-agronomike për regjistrimin e PMB-së.”

Neni 24

Neni 45 ndryshohet si vijon:

“Inspektorët në Drejtorinë e Bujqësisë në rreth kontrollojnë zbatimin e këtij ligji dhe pajisin me certifikatë fitosanitare bimët dhe produktet bimore.

Agronomi i mbrojtjes së bimëve në laboratorin e rrethit bën:

- diagnostikimin dhe prognozë - sinjalizimin e parazitëve të bimëve, duke këshilluar edhe masat e luftimit të tyre;

- analizat fitosanitare për bimët dhe produktet bimore që janë objekt i inspektimit, kur inspektori e gjykon të nevojshme.”

Neni 25

Nenet 36, 37, 38, 39, 40, 41, 46, 47 paragrafi i dytë dhe neni 49 paragrafi i dytë, shfuqizohen.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2453, datë 5.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

L I G J

Nr.8530, datë 23.9.1999

PËR SHËRBIMIN POSTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon ofrimin e veprimtarive postare, kushtet e kryerjes së shërbimeve postare, rolin e shtetit në sektorin postar, si dhe të drejtat dhe detyrat përkatëse të operatorëve dhe të përdoruesve.